

## RELACION

### PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016, DATË 06.10.2016, “PËR STATUSIN E GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Kuvendi i Shqipërisë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ka miratuar ligjin me “ 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si pjesë të paketës të ligjeve prioritare të reformës në sistemin e drejtësisë.

Ky ligj ka vendosur një sërë garancish ligjore në drejtim të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor me qëllim ndërtimin e një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm, të përgjegjshëm, të drejtë e profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në këtë projektligj janë të domosdoshme me qëllim:

-përmirësimin e rregullimeve ligjore lidhur me kryerjen e ceremonisë publike të betimit si dhe plotësimin e vakumit ligjor të procedurës së betimit, në rast të përfundimit të afatit ligjor për kryerjen e ceremonisë së betimit për magjistratët para fillimit të ushtrimit të funksionit, Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për anëtarin e Gjykatës së Lartë.

Plotësimi i këtij vakumi ligjor është i nevojshëm për të garantuar mirëfunksionimin e organeve gjyqësore dhe të prokurorisë, duke marrë në konsideratë që betimi është një moment i rëndësishëm, me të cilin lidhet fillimi i ushtrimit të mandatit të subjekteve të sipërcituara;

-përmirësimin e parashikimit ligjor, sa i takon organeve kompetente në periudhën kalimtare, duke marrë në konsideratë konstituimin e organeve të reja të sistemit të drejtësisë të cilat ushtrojnë funksionet dhe kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji nuk është përfshirë në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, por është në përputhje me objektivat madhorë dhe politikat e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për konsolidimin dhe forcimin e sistemit të drejtësisë.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet dhe shtesat e parashikuara në projektligj që kanë të bëjnë me përcaktimin e qartësisë ligjore të procedurës së betimit të subjekteve të sipërcituara, propozohen pasi gjyqtari apo prokurori i zgjedhur nga organi përkatës nuk mund të pengohet në ushtrimin e detyrës së tij, për shkak të mos organizimit të ceremonisë së betimit, pavarësisht arsyeve apo shkaqeve që mund të ekzistojnë për moskryerjen e kësaj procedure.

Rivendosja e besimit të publikut në sistemin gjyqësor dhe organin e prokurorisë është një nga shqetësimet kryesore të reformës në drejtësi. Mundësia për të pezulluar nga detyra gjyqtarët dhe prokurorët të cilët, bazuar në të dhëna thelbësore faktike që rrjedhin nga burime të besueshme, dyshohet se kanë kryer një shkelje të rëndë, që mund të justifikojë shkarkimin e magjistratit, është një element thelbësor për të arritur këtë besim. Për rrjedhojë, ligji kishte parashikuar mundësinë e pezullimit diskrecional të magjistratit përpara fillimit të një procedimi disiplinor. Me vendimin nr. 34/2017, Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi këtë dispozitë si në kundërshtim me Kushtetutën. Për të lejuar pezullimin nga detyra të magjistratit në rastet kur sjellja e tij rrezikon të diskreditojë figurën e një magjistrati në publik, që është praktika më e mirë në shumë Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian, është e nevojshme që të ketë filluar procedimi disiplinor. Hetimet disiplinore mund të zgjasin deri në një vit. Në rastin kur, për shembull, magjistratët dyshohet të jenë të përfshirë në një krim, por që nuk janë në kushtet e një mase sigurimi “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” dhe përpara marrjes së cilësisë së të pandehurit, Këshilli përkatës nuk do të kishte mundësi të kryente pezullimin nga detyra, refekruar parashikimeve ligjore ekzistuese. Kështu, magjistrati do të vazhdonte të gjykonte ose të ushtronte ndjekje penale, çka do të rrezikonte të dëmtonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Për të evituar këtë mundësi, ndryshimet e propozuara si më poshtë parashikojnë mundësinë e këshillave përkatës (KLGJ/KLP) që të vendosin lidhur me pezullimin mbi bazë diskrecionare të magjistratit të përfshirë në një procedim disiplinor që në momentin e fillimit të hetimit disiplinor.

Ndryshimi i nenit 152 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, vjen si nevojë e përcaktimit të hetimit paraprak që kryen Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi verifikimin e besueshmërisë së burimit të informacionit apo ankesës së paraqitur dhe pas rezultatit pozitiv të këtij procesi, i paraqet Këshillit përkatës kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor dhe pezullimin e magjistratit. Sipas këtij projektligji, Këshilli ka të drejtën që të kërkojë informacione të mëtejshme nga subjektet publike dhe private dhe vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për pezullim jo më vonë se 3 ditë pas paraqitjes së kërkesës.

Gjithashtu, dispozitat kalimtare të Kushtetutës dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, parashikonin që Inspektori i Lartë i Drejtësisë të ngrihej përpara shpërndarjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Qëllimi i dispozitave kalimtare të këtij ligji konsistonte në vazhdimësinë e mirëfunksionimit të sistemeve disiplinore, gjatë gjithë periudhës

kalimtare deri në konstituimin e institucioneve të reja, të cilat do të merrnin përsipër këto përgjegjësi.

Ndryshimet janë kryer në nenin 160, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, ku janë identifikuar Këshillat si organet kompetente për të vepruar gjatë periudhës kalimtare, deri sa të jetë funksional Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke ushtruar funksione disiplinore për gjyqtarët dhe për prokurorët. Këshillat sigurojnë, përmes masave administrative, pavarësinë organizative dhe funksionale të njërive të posacme të caktuara përkohësisht dhe miratojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe është në përputhje me parimet kushtetuese dhe legjislacionin në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektakti nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian andaj nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji i propozuar përmban gjithsej 6 nene, përmbajtja e të cilave parashtrohet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

**Neni 1**, parashikon se në nenin 37 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- në pikën 2, pas fjalës “ceremoni publike” shtohen fjalët “përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë”. Këshillat organizojnë ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit të magistratëve.

- pika 3 parashikon se pas përfundimit të këtij afati, magistrati kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të tij me shkrim pranë organit të emërtesës konsiderohet si dita e fillimit të detyrës së magistratit dhe përfshihet në dosjen personale të magistratit.

**Neni 2**, përcakton ndryshime në nenin 61 të ligjit, duke parashikuar në pikën 2 se mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë që përzgjidhen mes juristëve të spikatur fillon në ditën e betimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e emërimit ose e shpalljes i emëruar. Nëse anëtari i Gjykatës së Lartë nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe përfshihet në dosjen e tij personale.

Ndërkohë, pika 2/1 e shtuar, parashikon lidhur me mandatin e Prokurorit të Përgjithshëm se fillon në ditën e betimit. Ceremonia e betimit organizohet nga Kuvendi jo më vonë se 10 ditë

nga data e emërimit ose shpalljes i emëruar. Nëse Prokurori i Përgjithshëm nuk është thirrur për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Kuvendit dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Data e organizimit të ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim pranë Kuvendit konsiderohet si dita e betimit dhe e fillimit të detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe përfshihet në dosjen e tij personale.

Pika 2/2 e shtuar përcakton se mandati i anëtarëve të Gjykatës së Lartë që ngrihen në detyrë nga radhët e gjyqtarëve fillon në datën e emërimit ose shpalljes i emëruar, ndërsa mandati i prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme fillon në datën e ngritjes së tyre në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (pika 2/3 e shtuar e projektligjit).

**Neni 3**, parashikon se në nenin 130, pika 2, fjalët “institucione të tjera shtetërore, organizata” zëvendësohet me fjalët “institucion publik apo subjekt privat”.

**Neni 4**, përmban parashikime mbi ndryshimin e nenit 152 të ligjit, duke përcaktuar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen menjëherë një hetim paraprak për të verifikuar besueshmërinë e burimit të informacionit sipas nenit 124 ose ankesës së paraqitur nga subjektet e përcaktuara në nenin 119, kur ka dyshim të arsyeshëm se një magjistrat ka kryer një shkelje të rëndë. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë përcakton se burimi i informacionit ose ankesa është e besueshme, i paraqet Këshillit përkatës kërkesën e arsyetuar për fillimin e një procedimi disiplinor dhe për pezullimin e magjistratit, brenda 3 ditëve nga marrja e ankesës ose nga momenti që ka marrë dijeni për informacionin e parashikuar në nenin 124.

Këshilli pezullon magjistratin, nëse krijon bindjen se vazhdimi i detyrës së magjistratit, dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë figurën dhe pozitën e magjistratit. Këshilli mund të kërkojë informacione të mëtejshme nga subjektet publike dhe private dhe vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për pezullimin e tij jo më vonë se 3 ditë pas paraqitjes së kërkesës. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156 të këtij ligji.

Ky nen përcakton gjithashtu në pikën 4, se kur kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor është bazuar në hetimin parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, Këshilli pezullon procedimin disiplinor dhe i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të hetojë më tej shkeljen disiplinore. Procedura para Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ushtrohet në përputhje me afatet e parashikuara në nenin 118 të këtij ligji. Këshilli shqyrton çështjen me përparësi pas pranimin të raportit të hetimit dhe dosjes së hetimit (pika 5).

**Neni 5**, parashikon ndryshime në nenin 160 të ligjit, duke parashikuar se:

Deri në gjashtë muaj pas krijimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shkeljet disiplinore të magjistratëve, ndiqen dhe hetohen nga Këshillat, nëpërmjet njësive të përkohshme, që përbëhen nga magjistratë të komanduar sipas parashikimeve të neneve 53 -54 të këtij ligji dhe që zbatojnë për aq sa është mundur rregullat procedurale dhe kriteret e parashikuara në Pjesën V, Kreun I, II dhe V të këtij ligji. Afati 6 mujor është parashikuar në përputhje me parashikimet e Ligjit 115/2016 që përcakton këtë periudhë për bërjen funksionale të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshillat duhet të sigurojnë përmes masave administrative, pavarësinë organizative dhe funksionale të njëjësive të vecanta dhe miratojnë rregulla për organizimin dhe funksionimin e tyre.

**Neni 6**, parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektligji ngarkohen të gjitha organet shtetërore, fusha e veprimtarisë shtetërore e të cilëve preket nga përmbajtja e tij.



## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është nismë deputetësh.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk parashikon efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

### **DEPUTETËT**

1. Alket Hysoni 
2. Arshel Shacheti 
3. Edmond Leka 